

ABI INVEST Sha

RAPORT VJETOR

VITI I MBYLLUR 2024

ABI Invest Sha

ABI EIA

ABI FLEX EURO

ABI FLEX USD

Pasqyra e Lëndës

1. Rreth ABI Invest Sha	3
2. Vizioni	3
3. Misioni	3
4. Objektivat	3
5. Qeverisja Korporative	4
6. Transparenca	5
7. Kujdesi	6
8. Konflikti i Interesit	6
9. Përgjegjësia Sociale	6
7. Trajnime	Error! Bookmark not defined.
8. Fondet e Investimit	10
9. Treguesit e Riskut	Error! Bookmark not defined.

1. Rreth ABI Invest Sha

ABI INVEST sh.a. është një institucion financiar i regjistruar si Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive bazuar në ligjin 56/2020, datë 30.04.2020.

Aktiviteti i Shoqërisë i nënshtrohet Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Per Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" hyrë në fuqi më 20 qershor 2020 (duke shfuqizuar Ligjin nr. 10 198 datë 10.12.2009 dhe çdo akt tjetër që bie ndesh me të), Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe është në përputhje me të gjitha aktet nënligjore të aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Shoqëria është regjistruar si Shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër regjistrimi (NUIS) L92424002L më 24 dhjetor 2019 dhe është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me datë 27.02.2020. Fondi i parë i licensuar i Shoqërisë është "ABI EIA" si sipërmarrje e investimeve kolektive me vendimin nr. 203 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare më datë 29 dhjetor 2020. . Fondet ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD janë liçencuar nga Autoriteti me vendimet nr 110 dhe 112 datë 30.06.2021.

Selia Qendrore e Shoqërisë "ABI INVEST sh.a." është: Rruga e Kavajës, ndërtesa nr.27, Hyrja 1. Kati II, Njësia Bashkiake 10, Kodi Postar 1001.

Shoqëria zotërohet 100% nga "Banka Amerikane e Investimeve sh.a." ("Mëma") që nga data e themelimit të saj. Shoqëria "ABI Invest sh.a." funksionon si Shoqëri aksionare me sistem administrimi me një nivel.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 3 (tre)

2. Vizioni

Të jemi një partner i besuar dhe i përzgjedhur për klientët tanë duke i mbështetur ata drejt përbushjes së objektivave të tyre financiare duke ofruar oportunitet për të shtuar vlerë dhe për të diversifikuar investimet e tyre. Të jemi një punëdhënës i standardeve më të larta dhe të kontribuojmë pozitivisht për zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në vendin tonë.

Misioni

Misioni ynë është të rrisim vlerën e investimeve të klientëve tanë duke duke realizuar kthime të kënaqshme nga investimi. Ne e realizojmë misionin tonë me anë të zbatimit të strategjive tona të investimit duke u mbështetur gjithmonë në vlerat dhe parimet tona që janë integritet, përkushtim, pozitivitet, profesionalizëm, dhe sofistikim. Manaxhimi profesional i aseteve dhe kultura jonë e punës mundëson realizimin e misionit tonë çdo ditë.

3. Objektivat

T'u ofrojmë investitorëve një mënyrë investimi të qartë dhe transparente;

T'u japim investitorëve mundësinë për të vepruar së bashku, duke rritur avantazhet dhe mundësitë;

T'u ofrojmë investitorëve mundësi për diversifikimin e aseteve të tyre si dhe mundësi për përfitim në bazë të riskut;

Të edukojmë klientët tanë mbi mundësitë që ofrojmë dhe të rrisim gamën e produkteve në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

4. Qeverisja Korporative

ABI Invest sh.a është shoqëri aksionare, me seli në Rrugë e Kavajës 27/1, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Banka Amerika e Investimeve Sha.

Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratori

Këshilli i Administrimit:

Këshilli i administrimit ka në përbërje pesë anëtarë si më poshtë:

Z. Armand Muharremi: Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Muharremi, aktualisht në pozicionin e Drejtorit të Divizionit të Financës së Bankës Amerikane të Investimeve ka një eksperiencë të gjerë në sektorin bankar, të taksave dhe të auditit. Z. Muharremi filloi karrierën e tij me KPMG Shqipëri si auditor, dhe shumë shpejt u promovua si Supervisor i Auditit. Ai vazhdoi karrierën e tij në Auditim në bankën "Societe Generale", Shqipëri në vitin 2004 në pozicionin e Drejtuesit të Kontrollit të Brendshëm dhe më vonë e Drejtuesit të Divizionit të Financës. Z. Muharremi vijoi karrierën e tij në Audit dhe Financë me Ernst & Young (2009 – 2011) dhe me "Crédit Agricole", Shqipëri që prej vitit 2011 si Drejtor i Divizionit të Financës. Eksperienca e tij e gjatë në sistemin bankar në Shqipëri është një avantazh i madh për Grupin Financiar ABI. Z. Muharremi është diplomuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë në degën "Menaxhim Biznesi" në vitin 1998.

Znj. Teuta Çinari: Zv-Kryetare e Këshillit të Administrimit

Znj. Çinari, aktualisht mban pozicionin e Drejtores së Departamentit të Thesarit pranë Bankës Amerikane të Investimeve. Ka një eksperiencë 20 vjeçare në sektorin Bankar, specifikisht në profilin e administrimit të produkteve të Thesarit e gjithashtu në hartimet dhe aplikimet e politikave të ndryshme të lidhura me profilin, si ajo e investimeve, likuiditetit, normave të interesit, vlerësimit të titujve etj. Znj. Çinari është drejtuese/koordinuese në marrëdhëniet me Bankën dhe Bankën së Shqipërisë në proceset e licencave apo zgjerimit të licencave të veprimtarive të fushës së Thesarit e më gjerë. Znj. Çinari është diplomuar në vitin 2001 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë në degën "Ekonomiks - Statistikë e aplikuar".

Zj. Brikena Hoxha: Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Hoxha ka eksperiencë të gjërë në të drejtën publike dhe private në ShBA ku ka punuar si avokate në studio ligjore prestigjioze për çështje gjyqësore në lidhje me instrumenta financiare, krimin ekonomik, kontrata dhe shoqëritë (2005 – 2009). Në Shqipëri e Kosovë ka punuar me organizata ndërkombëtare duke dhënë konsulencë në hartimin e legjislacionit ekonomik, të drejtën administrative, në çështje gjyqësore etj. Znj. Hoxha është e licensuar dhe pranuar avokate në Dhomën e Avokatëve të Shtetit të Neë York-ut, SHBA. Që prej Tetorit 2015, ajo punon si Drejtore e Departamentit Ligjor, në Divizionin Ligjor dhe të Përputhshmërisë të Bankës Amerikane të Investimeve SHA. Znj. Hoxha është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në 2001 dhe zotëron një Master në Drejtësi (LL.M.) nga Universiteti i "Columbia", Fakulteti i Drejtësisë, Neë York, SHBA (2003).

Z. Redi Hakani: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Hakani ka një eksperiencë 15 vjeçare në sektorin Bankar, fillimisht në Kontabilitet dhe më pas në profilin e Thesarit. Më së fundmi, Supervisor i Sektorit të Menaxhimit të Aktiv- Pasiveve në Bankën Amerikane të Investimeve Sha. Ndër detyrat e përgjegjësitë kryesore, vend të rëndësishëm ka zënë veprimtaria me letrat me vlerë, më konkretisht investimet, monitorimi i impakteve në portofol të investimeve, aplikime të provave të rezistencës në terma likuiditeti e të normave të interesit, analiza të ecurive të normave të interesit, analiza produkteve, kërkim/analiza tregu, monitorim treguesish të brendshëm etj. Z. Hakani është diplomuar në vitin 2005 nga Universiteti i Tiranës, në degën "Financë".

Z. Niko Kotonika: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Kotonika ka një eksperiencë të gjatë në fushën e thesarit, investimeve, menaxhimit e likuiditetit si edhe tregtimin e titujve. Përpara se të bashkohej me grupin ABI, z. Kotonika ka ushtruar për një kohë të gjatë funksionet e Drejtorit të Thesarit të Bankës NBB, si edhe Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Gjatë kohës kur punonte për AMF, z.Kotonika ka drejtuar grupet e punës të ngarkuar për propozimin e kuadrit

të ri ligjor në lidhje me fondet e investimeve dhe tregjet e kapitalit. Gjatë kësaj kohe Z.Kotonika ka marrë pjesë gjithashtu në trajnime të ndryshme në lidhje me tregjet e kapitalit dhe fondet e investimeve ku mund të përmendet trajnim pranë Komisionit të Titujve edhe Bursave (SEC) në SHBA etj. Z. Kotonika është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe që prej Shtatorit 2012, mban titullin CFA (Analist i Certifikuar Financiar) lëshuar nga Instituti CFA me bazë në Charlottesville, Virginia, SHBA. Së fundmi z.Kotonika ka mbajtur pozicionin e Këshilltarit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv pranë ABI BANK.

Menaxhimi i Shoqërisë

Z. Niko Kotonika – Administrator i Përgjithshëm

Përgjegjës i Zyrës Kryesore (Operative) me përgjegjësi kryesore, por jo limituara vetëm tek të mëposhtmet:

Menaxhimin e investimeve sipas prospekteve të dizenuara për çdo fond;

- Organizimin e shitjeve të fondeve të investimeve nëpërmjet kanaleve shitëse;
- Përgatitjen e materialeve të marketing-ut për fondet;
- Kryerjen e analizave të ndryshme për optimizimin e kthimeve të investimeve; etj

Z. Brian Balliu – Drejtor i Menaxhimit të Riskut

Përgjegjës i Njesisë së Menaxhimit të Riskut me përgjegjësi kryesore, por jo të limituara vetëm tek të mëposhtmet:

Krijimin dhe implementimin e një sistemi për administrimin e riskut i cili përfshin monitorimin e politikave të vendosura, në mënyrë që të identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen, në mënyrë të vazhdueshme të gjitha risqet kryesore me të cilat haset shoqëria gjatë kryerjes së aktivitetit të saj.

Zhvillim të strategjisë e politikave të miratuara nga Këshilli i Administrimit lidhur me administrimin e Riskut;

Të sigurojë ndjekjen dhe respektimin e limiteve të brendshme dhe rregullative dhe të raportojë çdo kapërcim të këtyre limiteve;

Funksionet e Deleguara

Delegimi i funksioneve të shoqërisë administruese të palët e treta Shoqëria administruese ABI Invest ka vendosur të delegojë një pjesë të funksioneve të përcaktuara në ligjin 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", ABI Bank Sh.a. Shoqëria deklaron se delegimi është kryer duke patur parasysh interesin më të mirë të investitorëve, si edhe pavarësisht faktit se këto funksione janë deleguar, Shoqëria Administruese do të mbetet përgjegjëse për çdo veprim apo mosveprim në lidhje me funksionet e deleguara

Struktura Organizative

Me vendimin e Këshillit të Administrimit në datë

5. Transparenca

ABI Invest e trajton Transparencën ndaj Investitorit, si një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të saj. Shoqëria publikon raportet periodike të saj dhe të fondeve nën administrim, çdo përditësim në dokumentacion, informacion për ecurinë ditore të NAV, çmimit dhe numrit të kuotave. Çdo investitor mund të kontrollojë nëpërmjet aksesit nga website www.abinvest.al llogarinë e tij ku mund të marrë informacion mbi ecurinë e investimit dhe të portofolit në tërësi.

6. Kujdesi

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë në të njëjtin këndvështrim të atij të administrimit të financave dhe investimeve personale të vetë personelit kyç i cili ka në ngarkim këtë funksion. Përpjekje maksimale e transparente kryhen për të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve me aplikimin e masave prudeniale të riskut pa prapaskena arbitrazhi e spekulimi, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

7. Konflikti i Interesit

Shoqëria administruuese, vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në çdo lloj sipërmarrjeje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruuese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të.

8. Përgjegjësia Sociale

Më poshtë aktivitetet e përgjegjësisë sociale të grupit ABI BANK.

ABI Bank dhuron gjak

Stafi i ABI Bank iu bashkua sërish me shumë dashuri dhe përgjegjshmëri, nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar, për dhurim gjaku vullnetar në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

Mbështetje për shoqatën e të verbërve të Shqipërisë

Projekti “të-verbër-por-të-etur-për-të-lexuar” i zbatuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë synon ndarjen e një pasioni të përbashkët: dëshira e të verbërve për të eksploruar botën përmes faqeve të librave.

Java e Parasë – 2024

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti në Javën e Parasë konkursin nën sloganin: “Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde!”. Pjesëmarrës në këtë konkurs me projektet e tyre, ishin nxënësit e klasave të treta nga shkolla të ndryshme të gjithë vendit, të cilët u angazhuan në trajtimin e kësaj teme.

ABI Bank mbështet gjithmonë projektet që kanë në vëmendje edukimin financiar të brezave të ardhshëm.

Mbështetje e projektit “SË BASHKU NE MUNDEMI TË NGJISIM EDHE MALIN MË TË LARTË!”

ABI Bank ka mbështetur projektin “SË BASHKU NE MUNDEMI TË NGJISIM EDHE MALIN MË TË LARTË!” në mbrojtje të vajzave dhe grave, viktimat të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Ky projekt është pjesë e një lëvizjeje globale, e nxitur nga besimi se së bashku ne mund të ngjitemi edhe në majat më të larta.

Fondacioni “Misioni Emanuel”

Abi Bank ka mbështetur projektin “E ardhmja për fëmijët” me qëllim promovimin për zhvillimin dhe mbështetjen publike ndaj grupeve në nevojë për një periudhë 1 vjeçare.

Programi zhvillohet në qytetin e Korçës dhe konsiston në mbështetjen e 100 fëmijëve të grupmoshës 6-15 vjeç përmes programeve të dedikuara në qendrat ditore të hapura për fëmijët të cilët vijnë nga familje të marginalizuara.

Qendra e Artit dhe Kulturës, Korçë

Abi Bank mbështeti eventin me mbulimin e shpenzimeve për foninë në inagurimin e “Qendrës së Artit dhe Inovacionit”, Korçë.

Hackathon-Identitek

Stafi i ABI Bank iu bashkua me shumë dashuri dhe përgjegjshmëri, nismës së “Identitek”, për projektet inovative të 9 grupeve të rinjsh nga 9 Universitete mbi digitalizimin e shërbimeve të ndryshme për dokumentat e identifikimit, digitalizimin e shërbimeve shëndetësore, etj.

Sëing Marathon 6th Edition

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti “Sëing Marathon” organizuar nga “Shoqata Hemingëay Fun Club”, për të 6-in edicion në qytetin e Shkodrës. ABI Bank mbështet gjithmonë projektet që kanë në vëmendje zhvillimin dhe promovimin e qyteteve tona.

ABI Bank mbështet “A night of color”

Më 16 maj, Hotel Plaza priti darkën e përvitshme gala “A night of color”, organizuar nga aktivistë të komunitetit LGBT në Tiranë. Në luftën kundër diskriminimit, ABI mbështeti për të shtatin vit radhazi këtë aktivitet bamirësie, misioni i të cilit është të sigurojë fonde dhe vazhdimësi akomodimi, ushqimi, mbështetje psiko-sociale, trajnime gjatë gjithë jetës, edukim dhe punësim për të rinjtë LGBT që jetojnë në Qendra Streha dhe që kanë rënë viktima të abuzimit dhe diskriminimit.

Konferenca Ndërkombëtare e Informimit - Komisioneri për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

ABI Bank mbështeti edicionin e 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Informimit organizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave. Përfshirja në këtë event tregon angazhimin e Bankës në promovimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në shoqëri.

Fondacioni i Nënës dhe Fëmijës

Abi Bank ka mbështetur projektin në ndihmë të Nënave dhe Bebeve të sapolindura në nevojë, në 2 maternitete publike në Tiranë, për blerjen e materialeve spitalore që u vijnë në ndihmë në ditët e para të jetës.

“Të Fshehta jashtë Ekranit” - Mevlan Shanaj

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti botimin e librit me titull “Te Fshehta jashtë Ekranit” një përmbledhje impresionesh dhe esesh për filmin, ku kanë spikatur emrat më të njohur të kinematografisë duke lëvruar vlerat që ata kanë dhënë.

Koncert - Elvina Kocillari

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti pianisten e njohur Elvina Kocillari në koncertin e saj të zhvilluar në Fakultetin e Arteve.

Krijimi i partneritetit efektiv ndërmjet shoqërisë civile dhe biznesit

ABI Bank mori pjesë në eventin “Krijimi i partneritetit efektiv midis shoqërisë civile dhe biznesit”, organizuar nga Partnerët Shqiptar me synimin për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe partneriteti midis shoqërisë civile dhe sektorëve të biznesit me një kontribut në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 70 përfaqësues të sektorit të biznesit dhe OJQ-ve. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës së Filantropisë.

Ekrani i artit Shkodër

ABI Bank mbështeti Festivalin “Ekrani i Artit Shkodër”, i cili u zhvillua në datat 5-9 qershor në qytetin e Shkodrës. Në këtë edicion të 45-të, festivali solli 45 filma, 3 ekspozita, 4 instalacione dhe biseda e orë të hapura me artistë e të ftuar.

Koncerti “Rikthimi i Dallëndyshes” - Ermonela Jaho

Sopranoja e njohur në botë, Ermonela Jaho, u kthye në Shqipëri me koncertin “Rikthimi i Dallëndyshe” në Teatrin e Operas dhe Baletit. ABI Bank ishte sponsor i përgjithshëm i këtij koncerti.

Festa e Birrës

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti edicionin e 18-të të Festës së Birrës në Korçë. Festivali u zhvillua në datë 14- 18 gusht 2024 me pjesëmarrje të shumë artistëve të njohur shqiptar dhe të huaj.

Porto Palermo Festival

ABI Bank mbështeti “Porto Palermo Festival” i cili u organizua në kalanë e Porto Palermos në datat 1 deri në 18 gusht 2024. Arti, trashëgimia kulturore, historia dhe natyra bëhen bashkë në edicionin e katërt të këtij festivali.

Master class by Terrence McNally

Eva Alikaj solli në skenën e Teatrit të Operas dhe Baletit shfaqjen “Master class by Terrence McNally”. ABI Bank ishte mbështetës i kësaj shfaqjeje.

Maratona “Këngë Moj”

ABI Bank mbështeti Maratonën “Këngë Moj” të zhvilluar në qytetin e Gjirokastrës me pjesëmarrjen e ikonave të muzikës qytetare folklorike popullore dhe të lehtë, duke promovuar zhvillimin kulturor dhe ekonomik të qyteteve shqiptare dhe trashëgiminë kulturore.

Hemingëay Jazz Fest

Për të disatin vit radhazi ABI Bank ishte sponsor i përgjithshëm i edicionit të 11-të të “Hemingëay Jazz Fest”, organizuar në Oborrin e Universitetit Politeknik të Tiranës në dt 19-21 korrik me pjesëmarrjen e jashtëzakonshme të yjeve botëror të xhazit.

Sunset City Melodies

Abi Bank mbështeti dy muzikantë të talentuar të cilët së bashku me violinistin shqiptaro-francez Kledis Rexho performuan në një eksperiencë unike me tingujt e muzikës klasike, folk dhe barok bazuar në filmat dhe muzikën e vendit tonë.

Festa e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Për të disatin vit radhazi, Banka Amerikane e Investimeve ishte partneri kryesor i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë, në organizimin e ceremonisë festive me rastin e festës së Pavarësisë së SHBA-ve.

ABI mbështet Doën Syndrome Albania

Muaji tetor, është muaji i ndërgjegjësimit mbi sindromën Doën. Shoqata Doën Syndrome Albania organizoi koncertin e bamirësisë në të cilën ABI Bank mori pjesë si sponsor i përgjithshëm duke treguar mbështetjen e vazhdueshme që jep për kauza të ndryshme sociale.

“Harmonia e Fëmijërisë” – ABI Bank mbështeti projektin për ndërtimin e një qendre ditore për fëmijët në Rrëshen

ABI Bank ishte pjesë e ankandit “Rrathë Dhurues” të organizuar për vitin e gjashtë radhazi nga Partners Albania. Në këtë event ABI mbështeti projektin “Harmonia e Fëmijërisë” që synon ndërtimin e një qendre ditore në Rrëshen për ofrimin e mbështetjes dhe aktiviteteve edukative, kreative dhe sportive për 700 nxënës duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe përfshirjen sociale.

“Ajo sheh muzikën” – ABI Bank mbështeti koncertin gjithëpërfshirës organizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

ABI Bank është përkushtuar të mbështesë aktivitete që frymëzojnë dhe promovojnë barazinë dhe përfshirjen sociale. Ky koncert bëri bashkë performancat e artistëve me aftësi ndryshe krah për krah me artistë të tjerë, ku dhe u përcollën mesazhe fuqie, bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirje.

Zë me Mirën Podcast

ABI Bank ka mbështetur podcast-in “Zë me Mirën”, të gazetares Mira Kazhani, për vetë fokusin që ky podcast ka, i cili pasqyron një sërë tematikash sociale, kulturore si dhe rrëfime personale, motivuese dhe informuese.

EKONOMIA

Konkursi i DPSHTRR-së “Transport, Inovacion dhe Siguri”

ABI Bank është bërë pjesë e iniciativës së DPSHTRR-së, duke mbështetur konkursin “Transport, Inovacion dhe Siguri”, i cili synoi përfshirjen e studentëve në përmirësimin e sektorit të transportit rrugor përmes inovacionit dhe teknologjisë moderne.

Restaurimi i Kishës Shën Nikolla në Vuno, Himarë

Restaurimi i Kishës Shën Nikolla në Vuno është një tjetër kontribut i ABI Bank për ruajtjen e vlerave historike dhe kulturore të vendit tonë. Me mbështetjen financiare të ABI Bank, ky projekt e riktheu kishën në një gjendje funksionale, duke siguruar mbrojtjen e vlerave të saj historike dhe trashëgiminë për brezat e ardhshëm.

Forumi Urban i Tiranës

ABI Bank gjatë datave 6-7 dhjetor, ka mbështetur Forumin Urban të Tiranës, i cili priti kryetarë të Bashkive, zyrtarë nga rajoni B40, një grup ekspertësh teknikë si dhe lider të mendimit mbi urbanizimin. Gjatë forumit u zhvilluan ligjërata të hapura për publikun, ëorkshop-e, eskursione të udhëhequra, për të ndarë njohuri dhe frymëzuar liderat e qyteteve si nxitës të ndryshimit urban duke investuar në mirëqënien e familjeve e veçanërisht fëmijëve. ABI Bank ka qenë dhe është gjithmonë e angazhuar ndaj zhvillimit urban dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës.

Dokumentar “Në Besë të Shqiptarëve”

Duke besuar në rëndësinë e madhe që arti e kultura ka, në përcimin e vlerave të vendit tonë, ABI Bank ka mbështetur dokumentarin e realizuar nga Rudina Xhunga dhe Dritare TV, “Në Besë të Shqiptarëve”, një vepër që vlerëson historinë, kulturën dhe traditën e mikpritjes shqiptare.

ART DHE KULTURE

Ekspozita “Sogno Divino” pranë Naan Gallery

ABI Bank ka mbështetur ekspozitën e quajtur “Sogno Divino”, një ekspozitë e cila ofroi për të gjithë artdashësit, për herë të parë në Shqipëri, 100 veprat origjinale të artistit surrealist Salvador Dali të cilat ilustrojnë “Komedinë Hyjnore” të Dante Alighierit. Përmes mbështetjes ABI Bank synon të frymëzojë e përafrojë komunitetin me artin.

Festivali i 63-të i Këngës në RTSH

Përgjatë datave 19 – 22 dhjetor, u zhvillua edicioni i 63-të i Festivalit të përvitshëm të muzikës shqiptare, ABI Bank si mbështetës i vazhdueshëm i aktiviteteve artistike e kulturore, gjatë këtij viti ka qenë sponsorizues edhe i Festivalit të Këngës, i cili nuk përcolli vetëm muzikë e performancë por edhe mesazhe të forta sensibilizuese përmes personazheve të ndryshëm publikë.

Kosmos Music Festival

ABI Bank ka mbështetur Kosmos Music Festival, një festival dedikuar muzikës klasike dhe asaj të dhomës. Me pjesëmarrjen e artistëve të njohur vendas dhe të huaj u organizuan 4 koncerte në datat 26 – 30 tetor. Kjo nismë përputhet me angazhimin e ABI Bank në mbështetje të artit dhe promovimin e zhvillimit kulturor në komunitet.

9. Trajnime

Gjatë vitit 2024 ABI Invest Sh.A ka organizuar trajnime me personelin shitës të Bankës Amerikane të Investimeve. Këto trajnime kanë patur karakter edukues dhe informues. Gjithashtu takime informuese dhe sqaruese organizohen ne cdo rast dhe me investiturë egzistues apo potenciale.

10.Fondet e Investimit

ABI Invest administron tre fonde investimi ABI EIA, ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD

10.1 Fondi i Investimit ABI EIA

Fondi i Investimit “ABI EIA” (në vijim: Fondi) është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, e veçantë, i licencuar më datë 29.12.2020 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit të Bordit nr. 203. Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij më 01.03.2021.

Depozitari i fondit është Banka Credins Sh.A

Kthimi historik i Fondit që nga themelimi deri në 31.12.2024 është 14.53% dhe gjatë vitit të fundit të plotë kalendarik 8.15%.

Aktivitetet e fondit investohen në përputhje me dispozitat dhe parashikimet e ligjit nr. 56/2020, date 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Investitorët ose mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e plotë ose të pjesshme të kuotave që zotërojnë.

Shoqëria Administruese i investon asetet kryesisht në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Fondi synon të sigurojë përfitueshmërinë nga investimi duke marrë parasysh tregun, shpërndarjen e portofolit, risqet me të cilat përballlet gjithashtu dhe kohëzgjatjen mesatare të portofolit të investimit.

Në mënyrë që të maksimizohet përfitueshmëria, do të synohet, duke marrë parasysh limitimet rregullative, risqet si dhe likuiditetet, në investime afatmesme – afatgjata kryesisht në letra borxhi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Maturiteti mesatar i ponderuar i portofolit të investimeve duhet të jetë më i vogël ose i barabartë me 7 vjet. Për dhjetor 2024, ky maturitet raportohet me i vogël se 6.95-vite.

Pasqyra e Pozicionit Financiar për fondin ABI EIA jepet si më poshtë

:

	Nota	Për periudhën 31 dhjetor 2024	Për periudhën 31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	7	49,604,933	200,169,509
Investime në letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	8	289,452,253	127,390,861
Llogari të arkëtueshme		6,042,719	2,292,911
TOTALI I AKTIVIT		345,099,905	329,853,282
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	9	291,782	279,422
Detyrime të tjera	10	317,532	236,526
TOTALI I DETYRIMEVE		609,314	515,948
VLERA NETO E AKTIVEVE		344,490,591	329,337,333
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		300,797	311,005
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		1,145.26	1,058.95

10.2 Fondi i investimit ABI FLEX EUR

Fondi i Investimit “ABI FLEX EUR” (në vijim: Fondi) është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, e veçantë, i cili u licencua më datë 30.06.2021 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit të Bordit nr. 112 nën administrimin e shoqërisë ABI Invest sh.a, ndërkohë ai ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare gjatë muajit tetor 2021 dhe veprimtarinë me çmim të ndryshueshëm më 18 nëntor 2021.

Depozitari i fondit është Banka e Parë e Investimeve Shqipëri Sha

Ndikimi i përgjithshëm i situatës së tregjeve ndërkombëtare për vitin 2024 ka qenë përgjithësisht pozitiv për Fondin, duke sjellë një rritje të normës së kthimit nga kuota në nivelin 8.03 % për vitin e plotë kalendarik të mbyllur 2024 (kthimi historik nga themelimi 7.45%).

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit ABI FLEX EUR mbështetet në ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” i cili ka hyrë në fuqi në 20 qershor 2020, rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese. Menaxheri i portofolit ndjek një politikë konservatore duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut të normave të interesit, rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Limitet e aplikuar për çdo rrezik janë të shfaqura në Politikën e Menaxhimit të Rrezikut (PMR). PMR gjithashtu përmban limite për çdo faktor rreziku të cilët kushtëzojnë humbjet e padëshiruara.

Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, të kushtëzuar nga qëllimi parësor i ruajtjes së vlerës së kapitalit dhe likuiditetit. Alokimi i aseteve do të jetë kryesisht në obligacione dhe aksione të cilat përbajnë rrezik minimal të kredisë por janë të ekspozuara ndaj rrezikut nga normat e interesit.

Pasqyra e Pozicionit Financiar për fondin e investimeve ABI FLEX EURO jepet si më poshtë:

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	7	43,133,439	74,420,160
Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë			
përmes fitimit ose humbjes	8	256,673,103	217,280,796
Llogari të arkëtueshme	9	3,855,482	2,735,644
TOTALI I AKTIVIT		303,662,025	294,436,600
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	10	515,157	494,899
Detyrime të tjera	11	230,081	228,801
TOTALI I DETYRIMEVE		745,238	723,700
VLERA NETO E AKTIVEVE		302,916,786	293,712,900
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		28,722	28,426
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		10,546.3401	10,332.7153

10.3 Fondi i investimit ABI FLEX USD

Fondi i Investimit “ABI FLEX USD” është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, e veçantë, e themeluar nga ABI INVEST sh.a. Fondi u licencua më datë 30.03.2021 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit të Bordit nr. 112 nën administrimin e shoqërisë ABI Invest sh.a, ndërkohë ai ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare gjatë muajit tetor 2021 dhe veprimtarinë me çmim të ndryshueshëm më 18 nëntor 2021.

Depozitari i fondit është Banka e Parë e Investimeve Sh.A

Ndikimi i përgjithshëm i situatës së tregjeve ndërkombëtare për vitin 2023 ka pozitiv për Fondin, duke sjellë një rritje të normës së kthimit nga kuota në nivelin (3.97)% për vitin e plotë kalendarik të mbyllur 2024 (kthimi historik është kthyer pozitiv nga themelimi prej 5.64%).

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit ABI FLEX USD mbështetet në ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” i cili ka hyrë në fuqi në 20 qershor 2020, rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese, miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese. Menaxheri i portofolit ndjek një politikë konservatore duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut të normave të interesit, rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Limitet e aplikuar për çdo rrezik janë të shfaqura në Politikën e Menaxhimit të Rrezikut (PMR). PMR gjithashtu përmban limite për çdo faktor rreziku të cilët kushtëzojnë humbjet e padëshiruara.

Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, të kushtëzuar nga qëllimi parësor i ruajtjes së vlerës së kapitalit dhe likuiditetit. Alokimi i aseteve do të jetë kryesisht në obligacione dhe aksione të cilat përmbajnë rrezik minimal të kredisë por janë të ekspozuara ndaj rrezikut nga normat e interesit.

Pasqyra e Pozicionit Financiar për fondin ABI FLEX USD jepet si më poshtë:

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë	7	14,920,456	11,882,566
Investime në letra me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	8	50,246,917	42,857,607
Llogari të arkëtueshme		216,241	332,196
TOTALI I AKTIVIT		65,383,614	55,072,369
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	9	(107,848)	(92,321)
Detyrime të tjera	10	(2,099,998)	(178,479)
TOTALI I DETYRIMEVE		(2,207,845)	(270,801)
VLERA NETO E AKTIVEVE		63,175,769	54,801,568
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		6,345	5,742
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		10,305	9,544.13